

VENDIM
Nr. 867, datë 10.12.2014

**PËR PROCEDURAT EBASHKËPUNIMIT NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS
SHTETËRORE¹**

(Ndryshuar me VKM-në nr. 139, datë 20.3.2019; nr. 435, datë 26.6.2024; nr. 727, datë 20.11.2024)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 24, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
TË PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij vendimi është rregullimi i mënyrës së bashkëpunimit nëpërmjet kërkimit të të dhënave, informacionit, ndihmës së nevojshme, ngritjes së grupeve të përbashkëta të punës për hartimin e strategjive, politikave, akteve dhe krijimit të njërive të përbashkëta për të kryer detyra administrative ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore me qëllim mirëfunksionimin e aparatit dhe veprimtarisë shtetërore, si edhe realizimin e detyrave administrative me shpejtësi, efikasitet dhe besueshmëri.

2. Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore realizohet në një nga format e parashikuara nga neni 24, i ligjit nr. 90/2012, dhe sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

3. Të gjitha institucionet e administratës shtetërore para, gjatë dhe në përfundim të procesit të bashkëpunimit janë të detyruara të japin ndihmën dhe kontributin e tyre me qëllim realizimin pa vonesa të funksioneve administrative dhe detyrave shtetërore.

4. Funkionarët, nëpunësit dhe punonjësit e administratës shtetërore, të cilët pengojnë procedurën e bashkëpunimit institucional, kanë përgjegjësi disiplinore sipas legjislacionit përkatës që rregullon marrëdhëniet e tyre të punës.

KREU II
**PROCEDURA E BASHKËPUNIMIT INSTITUCIONAL PËR SIGURIMIN E TË DHËNAVE,
INFORMACIONIT DHE NDIHMËS SË NEVOJSHME**

1. Institucionet e administratës shtetërore, nëpërmjet kësaj procedure, kanë të drejtë:

a) të kërkojnë nga institucionet e tjera të administratës shtetërore që t’u sigurohen të dhëna, informacione apo çdo lloj ndihme tjetër, të cilat janë të nevojshme për realizimin e detyrave funksionale të tyre;

b) të krijojnë rrjete profesionale ndërinstitutionale të nëpunësve për fusha të caktuara, të cilat kontribuojnë në rritjen e nivelit të bashkëpunimit dhe komunikimit, me synimin e:

i. shkëmbimit të eksperiencave më të mira, njohurive dhe praktikave për procese pune të ngjashme;

ii. shkëmbimit/ krahasimit të informacionit apo të të dhënave në fushën përkatëse;

iii. diskutimit të çështjeve apo problematikave;

iv. adresimit të kërkesave pranë institucioneve përgjegjëse për të bërë rregullime të posaçme nëpërmjet akteve rregullatore që mbulojnë fushën përkatëse.

2. Bashkëpunimi, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi, mund të shfaqet në një nga format

¹ VKM nr. 867, datë 10.12.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 193, datë 22 dhjetor 2014.

VKM nr. 139, datë 20.3.2019 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 41, datë 28 mars 2019.

e mëposhtme:

a) Kryeministria dhe ministrinë me institucionet e tyre të varësisë, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve, agjencitë autonome dhe me administratën e prefektit;

b) Kryeministria me ministrinë;

c) Ministrinë ndërmjet tyre;

ç) Kryeministria me institucionet e varësisë, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve apo agjencitë autonome, në varësi të ministrive;

d) Ministrinë me institucionet e varësisë, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve apo agjencitë autonome, në varësi të ministrive të tjera;

dh) Institucionet e varësisë, njësitë e drejt-përdrejta të ofrimit të shërbimeve, agjencitë autonome, brenda një sistemi ministrior;

e) Institucionet e varësisë, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve, agjencitë autonome, që i përkasin sistemeve ministriore të ndryshme, si dhe me administratën e prefektit.

3. Në çdo moment kur një institucioni të administratës shtetërore i nevojiten, me qëllim realizimin e funksioneve të tij, të dhëna apo informacione që disponohen nga një institucion tjetër, ai ka të drejtë t'i drejtohet drejtpërdrejt atij institucioni.

4. Kërkesa në këtë rast duhet të përmbajë:

a) organin që bën kërkesën;

b) llojin e të dhënave, informacionit apo ndihmës që kërkohet në këto raste;

c) arsyet e një kërkesë të tillë;

ç) argumentimin e urgjencës nëse ekziston;

d) nënshkrimin e titullarit të institucionit apo personit përgjegjës.

5. Institucioni pritës duhet të kthejë menjëherë përgjigje për kërkesën për bashkëpunim dhe kurdoherë brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim.

6. Afatet për kthimin e përgjigjeve janë, si më poshtë vijon:

a) Kur kërkesa bëhet nga Kryeministria apo institucionet, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve apo agjencitë autonome, në varësi të saj, drejtuar cilitdo institucion, afati për kthimin e përgjigjes është deri në 3 (tri) ditë pune për kërkesat e klasifikuara si urgjente dhe 7 (shtatë) ditë pune për kërkesat e klasifikuara si të zakonshme.

b) Kur kërkesa bëhet nga ministrinë, drejtuar Kryeministrit dhe/apo institucioneve, njësive të drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve apo agjencive autonome, në varësi të saj, afati për kthimin e përgjigjes është deri në 3 (tri) ditë pune për kërkesat e klasifikuara si urgjente dhe 9 (nëntë) ditë pune për kërkesat e klasifikuara si të zakonshme.

c) Kur kërkesa bëhet nga ministrinë për institucionet, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve apo agjencitë autonome, në varësi të tyre, afati për kthimin e përgjigjes është deri në 3 (tri) ditë pune për kërkesat e klasifikuara si urgjente dhe 7 (shtatë) ditë pune për kërkesat e klasifikuara si të zakonshme.

ç) Kur kërkesa bëhet nga ministrinë drejtuar ministrive të tjera, afati për kthimin e përgjigjes është deri në 3 (tri) ditë pune për kërkesat e klasifikuara si urgjente dhe 9 (nëntë) ditë pune për kërkesat e klasifikuara si të zakonshme.

d) Kur kërkesa bëhet nga ministrinë drejtuar institucioneve, njësive të drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve apo agjencitë autonome, në varësi të ministrive të tjera, si dhe administratës së prefektit, afati për kthimin e përgjigjes është deri në 4 (katër) ditë pune për kërkesat e klasifikuara si urgjente dhe 10 (dhjetë) ditë pune për kërkesat e klasifikuara si të zakonshme.

dh) Kur kërkesa bëhet nga institucionet, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve apo agjencitë autonome, në varësi të një ministrie, ose administrata e prefektit, drejtuar institucioneve, njësive të drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve apo agjencive autonome, në varësi të ministrive të

tjera, si dhe administratës së prefektit, afati për kthimin e përgjigjes është deri në 3 (tri) ditë pune për kërkesat e klasifikuara si urgjente dhe 12 (dymbëdhjetë) ditë pune për kërkesat e klasifikuara si të zakonshme.

7. Afati për kthimin e përgjigjeve fillon nga e nesërme e protokollimit të tyre në regjistrin përkatës të institucionit, të cilit i kërkohet informacioni, dhe mbaron në ditën përkatëse sipas afateve përkatëse brenda orarit zyrtar të asaj dite.

8. Institucioni pritës, për shkaqe me rëndësi dhe duke dhënë një përgjigje të arsyetuar, mund të shtyjë përgjigjen e tij përkatësisht sipas rastit deri në 3 (tri) ditë pune të tjera.

9. Në rastin kur kërkohen të dhëna, informacione apo ndihmë, për të cilat kërkohen njohuri të posaçme shkencore dhe mund të kërkohen ekzaminime apo eksperimente me karakter shkencor, afati për kthimin e përgjigjes nuk mund të jetë më shumë se 20 (njëzet) ditë pune.

10. Në rast se kërkesa ka të bëjë me të dhëna apo informacion të klasifikuar sekret shtetëror, vepron sipas legjislacionit përkatës që rregullon këtë fushë.

11. Kërkesat për bashkëpunim shqyrtohen nga institucioni pritës, sipas radhës së paraqitjes së tyre, me përjashtim të kërkesave për bashkëpunim që vijnë nga Kryeministria, të cilat kanë kurdoherë prioritet.

12. Në rast se përgjigja nuk është e plotë, institucioni dërgues ka të drejtë të kërkojë plotësimin e saj me të dhënat apo informacionin e duhur, duke specifikuar edhe afatin kohor për plotësimin e të metave.

13. Afati sipas pikës 12 nuk duhet të jetë më i vogël se 3 (tri) ditë pune dhe jo më shumë se 7 (shtatë) ditë pune.

14. Institucioni pritës mund të kundërshtojë kërkesën për bashkëpunim, nëse legjislacioni që rregullon fushën e veprimtarisë së tij dhe/apo legjislacioni i fushave të tjera të veçanta e pengon atë për dhënien e të dhënave, të informacionit apo të ndihmës së kërkuar.

15. Në rastin e parashikuar në pikën 14, të kreut II, të këtij vendimi, institucioni pritës, kurdoherë brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim, duhet të kthejë një përgjigje zyrtare refuzuese, në të cilën të saktësohet baza ligjore dhe të jepen shpjegimet e nevojshme për refuzimin e kërkesës për bashkëpunim me institucionin kërkuar.

16. Nëse institucioni kërkuar nuk merr përgjigjen në kohë apo nuk është i bindur nga arsyet e refuzimit të institucionit pritës, ai ka të drejtë t'i drejtohet institucionit epror të institucionit pritës, kur ky i fundit është institucion varësie, duke i kërkuar detyrimin e organit vartës për të dhënë të dhënat, informacionin apo ndihmën e kërkuar, dhe, nëse vonesa ka shkaktuar pasoja në veprimtarinë e institucionit dërgues, edhe propozimin për fillimin e ecursë disiplinore ndaj personave përgjegjës.

17. Kërkesa e përcaktuar në pikën 16, të kreut II, të këtij vendimi, përmban përveç elementeve të përcaktuara në pikën 4, të kreut II, të këtij vendimi, edhe një parashtrim të arsyeve të refuzimit të kërkesës për bashkëpunim, kur ato janë dhënë, si dhe argumentet se përse këto arsye nuk qëndrojnë. Kërkesës i bashkëlidhet edhe përgjigja zyrtare refuzuese e institucionit pritës, nëse një përgjigje e tillë është dhënë.

18. Institucioni epror, në rast se kërkesa e institucionit kërkuar i duket e bazuar, mund ta detyrojë institucionin e tij vartës për plotësimin e kërkesës për bashkëpunim ose ta zëvendësojë atë sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 23, të ligjit nr. 90/2012.

19. Institucioni epror, në rast se kërkesa e institucionit dërgues i duket e pabazuar, kthen një përgjigje të arsyetuar.

20. Në rast se institucioni dërgues është institucion varësie, ai ka të drejtë t'i drejtohet institucionit të tij epror për të kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së krijuar në këtë rast.

21. Në rastin e parashikuar në pikën 19, të kreut II, të këtij vendimi, nëse institucioni epror e konsideron të bazuar kërkesën e institucionit të tij vartës, i paraqet Kryeministrit kërkesën për

zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, duke parashtruar rrethanat e faktit, si dhe të gjithë dokumentacionin shoqërues, përfshirë edhe korrespondencën përkatëse.

22. Kryeministri në këto raste vepron sipas parashikimeve të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe Kodit të Procedurave Administrative.

23. *Rrjetet profesionale ndërinstitucionale të nëpunësve, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi, krijohen për të trajtuar çështje, të cilat lidhen me qëllimin e ekzistencës dhe/ose fushën e përgjegjësisë së institucionit që i krijon. Në to marrin pjesë nëpunës/punonjës të institucioneve të administratës shtetërore, të cilët janë të punësuar në njësitë organizative të ngarkuara me ekzekutimin e detyrave që lidhen me fushën për të cilën krijohet rrjeti dhe kanë njohuri e aftësi më të mira në këtë fushë.*

24. *Rrjetet profesionale ndërinstitucionale të nëpunësve ngrihen me urdhër të Kryeministrit, ministrit përkatës apo titullarit të institucionit, që ka në fushë përgjegjësie fushën për të cilën ngrihet rrjeti. Në urdhrin e ngritjes së rrjetit përcaktohen qëllimi, synimet e përfitimet, struktura udhëheqëse, struktura të tjera në përbërje të tij, nëse është rasti, anëtarët, detyrat e përgjegjësitë, mënyra e organizimit e funksionimit të tij dhe numri maksimal i anëtarëve. Si rregull, në përbërje të rrjetit nuk mund të ketë më shumë se 30 (tridhjetë) anëtarë.*

25. *Si rregull, struktura udhëheqëse e rrjetit profesional ndërinstitucional të nëpunësve është institucioni/njësia organizative, që ka kompetencat më të larta sa i takon fushës në të cilën ngrihet rrjeti.*

KREU III NGRITJA E GRUPEVE TË PËRBASHKËTA TË PUNËS

1. Grupet e përbashkëta të punës janë grupe me karakter të përkohshëm, të cilat ngrihen sipas rastit me urdhër të ministrit/ministrave apo Kryeministrit dhe kanë si qëllim hartimin e strategjive, politikave, studimeve ose projekteve të veçanta për administrimin e zbatimit të projekteve të Këshillit të Ministrave.

2. Këshilli i Ministrave, në çdo rast kur harton një projekt, përcakton edhe ministrin përgjegjës për zbatimin e tij. Nëse në projekt përfshihet fusha e përgjegjësisë së disa ministrave, atëherë Këshilli i Ministrave përcakton ministrin kryesor përgjegjës.

3. Në rast se Këshilli i Ministrave nuk ka caktuar ministrin përgjegjës në momentin e hartimit të projektit, atëherë ministri përgjegjës zgjidhet sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 24, të ligjit nr. 90/2012.

4. Për realizimin e projektit të Këshillit të Ministrave, ministri përgjegjës, në rast se grupi i punës mund të krijohet me mjetet dhe personelin e ministrisë që ai drejton apo të institucioneve që janë në varësinë e tij, nxjerr urdhrin për ngritjen e grupit të përbashkët të punës.

5. Në rastet kur projekti i Këshillit të Ministrave prek fushën e veprimtarisë, në përgjegjësi të disa ministrave dhe/apo të institucioneve në varësi të tyre, nxirret një urdhër i përbashkët i ministrave të përfshirë nën drejtimin e ministrit përgjegjës kryesor ose, sipas rastit, të Kryeministrit.

6. Në këtë rast, nismën për miratimin e urdhrin të përbashkët e ka ministri përgjegjës kryesor dhe, kur nuk është përcaktuar, ministri që ka më afër fushën e veprimtarisë, për të cilën është hartuar projekti i Këshillit të Ministrave.

7. Në urdhrin e përcaktuar në pikat 4 dhe 5, të kreut III, të këtij vendimi, duhet të përcaktohen:

- a) qëllimi i ngritjes së grupit të përbashkët të punës;
- b) objekti i grupit të punës;
- c) struktura përkatëse pranë së cilës do të funksionojë grupi i punës;
- ç) numri i punonjësve që do të përfshihen në grupin e punës dhe ndarja e detyrave;
- d) vendimmarrja e grupit;
- dh) infrastruktura e nevojshme;
- e) mjetet financiare, nëse është e nevojshme;
- ë) afati, brenda të cilit grupi i punës duhet të realizojë detyrat e tij.

8. Në qëllimin e ngritjes së grupit të përbashkët tregohet në mënyrë të përmbledhur projekti i Këshillit të Ministrave dhe detyrat që duhet të realizojë grupi i përbashkët për realizimin e tij.

9. Në objektin e grupit të punës tregohet në mënyrë konkrete detyra, për të cilën është ngritur grupi i punës, që mund të jetë hartimi i një strategjie, politike, studimi apo projektakti ose një kombinim i këtyre rasteve.

10. Në urdhrin për ngritjen e grupit të përbashkët të punës duhet të përcaktohet saktësisht struktura pranë së cilës ky grup do të mbledhet dhe do të funksionojë. Kjo strukturë është një njësi organizative pranë aparatit të Kryeministrit, ministrive apo institucioneve të varësisë.

11. Në përzgjedhjen e strukturës sipas pikës 10, të kreut III, të këtij vendimi, duhet të merret në konsideratë aksesimi i punonjësve që do të jenë pjesë e grupit, si dhe infrastruktura e nevojshme për realizimin e detyrave të tyre.

12. Në urdhrin për ngritjen e grupit të përbashkët të punës duhet të përcaktohen saktësisht numri i nëpunësve që do të marrin pjesë në të, profili, kualifikimi dhe cilësitë e nevojshme që duhet të kenë, si dhe, kur është rasti, ndarja e tyre për çdo institucion të përfshirë në këtë proces.

13. Në rastin kur kërkohet që pjesë e grupit të jenë edhe ekspertë të jashtëm, duhet që në urdhër të specifikohen arsyeja e marrjes së tyre, si dhe profili e kualifikimi që duhet të kenë.

14. Në këtë rast, në urdhër duhet të përcaktohet edhe drejtuesi i grupit të përbashkët ose institucioni që ka të drejtën e emërimit të tij.

15. Me miratimin e urdhrit, titullarët e institucioneve përkatëse të përfshira në këtë proces bëjnë caktimin e nëpunësve të tyre që do të jenë pjesë e grupit të përbashkët.

16. Caktimi i ekspertëve të jashtëm bëhet nga ministri përgjegjës kryesor.

17. Nëpunësit e caktuar duhet që menjëherë t'i bëjnë me dije titullarit të tyre nëse kanë konflikt interesi. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe nëse konflikti i interesit zbulohet më vonë.

18. Në rastin e përcaktuar nga pika 17, e kreut III, të këtij vendimi, ose në çdo rast tjetër pamundësie ligjore të nëpunësve të caktuar për të marrë pjesë në grupin e përbashkët, titullarët e institucioneve të përfaqësuara bëjnë zëvendësimet përkatëse.

19. Drejtuesi i grupit të përbashkët ka këto funksione:

a) Përfaqëson dhe drejton grupin e përbashkët;

b) U kërkon institucioneve të tjera përgjegjëse shpjegime, relatime dhe verifikime administrative për çështje të fushës që ata mbulojnë dhe që i shërbejnë punës së grupit të përbashkët. Në këtë rast, zbatohen me analogji dispozitat e kreut II, të këtij vendimi;

c) Organizon dhe asiston në mbledhjet e mbledhjeve të grupit të përbashkët;

ç) Ndjek procesin e vendimmarrjes së grupit të përbashkët, që nga paraqitja e projekteve për shqyrtim e deri sa ato marrin formë të plotë;

d) Përcakton detyrat për secilin prej anëtarëve të grupit të përbashkët dhe kontrollon zbatimin e tyre;

dh) Kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për realizimin e qëllimit, objektit dhe detyrave, për të cilat është ngritur grupi i përbashkët.

20. Mbledhjet e grupit janë të vlefshme kur në të marrin pjesë të paktën 2/3 e anëtarëve të grupit.

21. Për shkaqe të arsyeshme, kur mungon njëri prej anëtarëve të grupit, drejtuesi i tij mund të vendosë shtyrjen e mbledhjes për një datë tjetër.

22. Vendimet në grupin e punës merren me votim nominal dhe me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të grupit. Në rast të barazisë së votave, vota e kryetarit të grupit është përcaktuese.

23. Në urdhrin për ngritjen e grupit të përbashkët të punës duhet të përcaktohen saktësisht mjediset dhe mjetet e nevojshme materiale, të cilat do t'i shërbejnë grupit të përbashkët për realizimin e detyrave të tij funksionale. Në rast se janë përfshirë disa institucione, në urdhër përcaktohet përgjegjësia e çdo institucioni.

24. Në urdhrin për ngritjen e grupit të përbashkët të punës duhet të përcaktohen saktësisht mjetet buxhetore dhe financiare që duhet të mbulojnë veprimtarinë e tij, ku përfshihet, nëse ka, edhe pagesa e ekspertëve të jashtëm. Në rast se këto mjete nuk mbulohen nga buxhetet e institucioneve të përfshira ose nuk ishin parashikuar në fondet e tyre, atëherë përpara ngritjes së grupit kërkohet detyrimisht mendimi nga Ministria e Financave.

25. Ministria e Financave në bashkëpunim me institucionet e përfshira ndjek procedurat e nevojshme për shpërndarjen e fondeve, duke zbatuar legjislacionin përkatës për buxhetin e shtetit.

26. Në rast se mjetet financiare për grupin e përbashkët mbulohen nga një projekt i huaj, i dhënë nga organizma apo donatorë ndërkombëtarë, përdorimi i tyre bëhet në përputhje me marrëveshjen e arritur me këto subjekte, si edhe me legjislacionin përkatës për buxhetin e shtetit.

27. Në urdhrin për ngritjen e grupit të përbashkët të punës duhet të përcaktohen periodha kohore, brenda së cilës grupi i përbashkët i punës duhet të realizojë detyrat, dhe objekti për të cilin është krijuar.

28. Në urdhër duhet të përcaktohet, gjithashtu, dhe mënyra e arkivimit të dokumentacionit të prodhuar nga grupi i përbashkët me pushimin e ekzistencës së tij.

29. Të dhënat e sipërpërmendura mund të ndryshohen në çdo kohë, sipas rastit, nga ministri përgjegjës me urdhër apo ministrat e përfshirë me urdhër të përbashkët, duke përcaktuar qëllimin, objektin, afatin, personelin, infra-strukturën apo mjetet financiare të tjera, duke zbatuar në këtë rast kërkesat e pikave 7-25, të kreut III, të këtij vendimi.

KREU IV KRIJIMI I NJËSIVE TË PËRBASHKËTA

1. Njësitë e përbashkëta janë njësi të krijuara midis disa institucioneve me karakter të përkohshëm apo të përhershëm, të cilat krijohen sipas rastit me urdhër të ministrit apo ministrave dhe kanë si qëllim realizimin e detyrave administrative, të cilat për nga natyra e tyre kërkojnë pjesëmarrjen e disa institucioneve.

2. Njësitë e përbashkëta krijohen me personel dhe mjete nga institucione, të cilat janë në varësi të një ministri. Në këtë rast, urdhri për ngritjen e njësisë së përbashkët bëhet nga ministri përgjegjës që ka në varësi institucionet përkatëse.

3. Njësitë e përbashkëta mund të krijohen edhe midis ministrive apo institucioneve që janë në varësi të ministrave të ndryshëm. Në këtë rast, për krijimin e njësisë nxirret një urdhër i përbashkët i ministrave të përfshirë.

4. Nisma për ngritjen e njësisë mund të ndërmerret nga cilido institucion i cili ka interes në krijimin e tij.

5. Në rastin kur njësia e përbashkët do të krijohet për institucionet që janë në varësi të një ministri të vetëm, nisma mund të merret nga vetë ministri kryesisht apo nga institucionet në varësi.

6. Në rast se nisma merret nga institucionet në varësi, institucioni propozues duhet të paraqesë bashkë me propozimin edhe një relacion shoqërues, në të cilin të përcaktohen qëllimi i krijimit të njësisë së përbashkët, institucionet që do të përfshihen, detyrat administrative konkrete që do të realizohen bashkërisht, mënyra e realizimit të tyre, personeli i nevojshëm, mjetet financiare, infrastruktura e nevojshme dhe natyra e përkohshme apo e përhershme e njësisë.

7. Me marrjen e propozimit dhe relacionit shoqërues, ministri njofton nëpërmjet sekretarit të përgjithshëm, brenda 5 (pesë) ditëve pune, institucionet që propozohen të përfshihen.

8. Brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, institucioni që propozohet të përfshihet në krijimin e njësisë së përbashkët duhet të kthejë përgjigje të argumentuar për pranimin ose jo të propozimit.

9. Brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së përgjigjes sipas pikës 8, të këtij kreu, ministri vendos për krijimin ose jo të njësisë së përbashkët.

10. Në rastin e ngritjes së njësisë së përbashkët nga disa ministri apo nga institucione, që janë në varësi

të ministrave të ndryshëm, propozimi mund të vijë nga vetë ministrat e interesuar kryesisht apo nga vetë institucionet.

11. Në rast se propozimi vjen nga një prej ministrave, atëherë ai shoqërohet me një relacion, i cili përmban të dhënat e përcaktuara në pikën 6, të kreut IV, të këtij vendimi, dhe i drejtohet ministrit apo ministrave, strukturat e të cilëve, aparat ministrie apo institucione varësie, kërkohen të përfshihen në krijimin e njësisë së përbashkët.

12. Ministri apo ministrat e përfshirë duhet të përgjigjen brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së propozimit.

13. Në rast se kërkohet që në këtë procedurë të përfshihen edhe institucionet e tyre të varësisë, afati i përgjigjes është deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune, me qëllim që ministri, të cilit i është drejtuar propozimi, të marrë edhe mendimin e institucionit/institucioneve në varësi.

14. Në rast se propozimi vjen nga një institucion varësie, i cili kërkon të krijojë një njësi të përbashkët me një apo disa institucione në varësi të ministrave të tjerë, të ndryshëm nga ministri nën varësinë e të cilit ky institucion është, propozimi bashkë me relacionin shoqërues i dërgohet ministrit, në varësi të të cilit është institucioni propozues.

15. Institucioni i varësisë, në këtë rast, duhet që, brenda 5 (pesë) ditëve, të paraqesë propozimin te ministri, në varësinë e të cilit është.

16. Ministri që merr propozimin sipas pikës 15, të kreut IV, të këtij vendimi, vepron më pas me procedurën e propozimit të përcaktuar në pikën 11, të kreut IV, të këtij vendimi. Më pas, sipas rastit, zbatohen afatet e përcaktuara në pikat 12 dhe 13, të kreut IV, të këtij vendimi.

17. Në rastin e krijimit të njësisë së përbashkët sipas pikave 10-16, të kreut IV, të këtij vendimi, ministrat e përfshirë nxjerrin urdhrin e përbashkët.

18. Në raste të caktuara, nisma për krijimin e njësisë së përbashkët mund të merret edhe nga Kryeministri. Në këtë rast, propozimi shoqërohet me relacionin përkatës dhe u drejtohet ministrave që kërkohet të përfshihen. Ministrat janë të detyruara të japin përgjigje brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.

19. Në rast mosmarrëveshjeje midis ministrave për krijimin e njësisë së përbashkët apo në rast të nismës së ndërmarrë nga Kryeministri, sipas pikës 18, të kreut IV, të këtij vendimi, njësia e përbashkët krijohet me urdhër të Kryeministrit.

20. Në urdhrin për krijimin e njësisë së përbashkët duhet të përcaktohen:

- a) qëllimi i krijimit të njësisë së përbashkët;
- b) objekti i njësisë së përbashkët/detyrat administrative;
- c) struktura përkatëse pranë së cilës do të funksionojë njësia e përbashkët;
- ç) numri i punonjësve që do të përfshihen në njësinë e përbashkët dhe ndarja e detyrave;
- d) vendimmarrja e njësisë;
- dh) infrastruktura e nevojshme;
- e) mjetet financiare;

ë) natyra e njësisë, e përhershme apo e përkohshme, dhe, nëse është e përkohshme, afati brenda të cilit njësia duhet të realizojë detyrat e saj.

21. Në qëllimin e krijimit të njësisë së përbashkët tregohen në mënyrë të përmbledhur detyrat e përbashkëta që kërkohet të realizohen në këtë rast.

22. Në objektin e njësisë tregohen në mënyrë konkrete detyrat administrative, për të cilat është krijuar njësia dhe që mund të jenë inspektimi, kontrolli, sekuestrimi, konfiskimi, parandalimi, ndalimi dhe detyra të tjera të nevojshme për arritjen e qëllimit të përbashkët.

23. Në urdhrin për krijimin e njësisë së përbashkët duhet të përcaktohet struktura, pranë së cilës kjo njësi do të mbledhet dhe do të funksionojë. Kjo strukturë mund të jetë një njësi organizative pranë aparatit të Kryeministrit, ministrave apo institucioneve të varësisë.

24. Në përzgjedhjen e strukturës sipas pikës 23, të kreut IV, të këtij vendimi, duhet të merren në

konsideratë aksesit i punonjësve që do të jenë pjesë e njësisë, si dhe infrastruktura e nevojshme për realizimin e detyrave të tyre.

25. Në urdhrin për krijimin e njësisë së përbashkët duhet të përcaktohen numri i nëpunësve që do të marrin pjesë në të, profili, kualifikimi dhe cilësitë e nevojshme që duhet të kenë, si dhe, kur është rasti, ndarja e tyre për çdo institucion të përfshirë në këtë proces.

26. Në urdhër në këtë rast duhet të përcaktohet edhe drejtuesi i njësisë së përbashkët ose institucioni që ka të drejtën e emërimit të tij.

27. Me miratimin e urdhrit, titullarët e institucioneve përkatëse të përfshira në këtë proces bëjnë caktimet e nëpunësve të tyre që do të jenë pjesë e njësisë së përbashkët.

28. Nëpunësit e caktuar duhet që menjëherë të deklarojnë nëse kanë konflikt interesi. Konflikti i interesit deklarohet edhe në rastet kur ai lind gjatë ushtrimit të detyrës.

29. Në rastin e përcaktuar nga pika 29, e kreut IV, të këtij vendimi, ose në çdo rast tjetër pamundësie ligjore të nëpunësve të emëruar (të caktuar) për të marrë pjesë në njësinë e përbashkët, titullarët e institucioneve emëruese bëjnë zëvendësimet përkatëse, brenda 2 (dy) ditëve pune.

30. Drejtuesi i njësisë së përbashkët ka këto funksione:

a) Përfaqëson dhe drejton njësinë e përbashkët;

b) U kërkon institucioneve të tjera përgjegjëse shpjegime, relatime dhe verifikime administrative për çështje të fushës që ata mbulojnë dhe që i shërbejnë punës së njësisë së përbashkët. Në këtë rast, zbatohen me analogji dispozitat e kreut II, të këtij vendimi;

c) Organizon dhe asiston në mbarëvajtjen e mbledhjeve të njësisë së përbashkët;

ç) Ndjek procesin e vendimmarrjes së njësisë së përbashkët dhe kujdeset për realizimin e detyrave administrative përkatëse;

d) Përcakton detyrat për secilin prej anëtarëve të njësisë së përbashkët dhe kontrollon zbatimin e tyre;

dh) Kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për realizimin e qëllimit, objektit dhe detyrave për të cilin është krijuar njësi e përbashkët.

31. Njësitë e përbashkëta të përhershme funksionojnë si struktura ekzekutive /urdhërdhënëse, me qëllim realizimin dhe përmbushjen e detyrave administrative të përbashkëta të institucioneve të përfshira në këtë njësi.

32. Në urdhrin për ngritjen e grupit të përbashkët, autoritetet e përfshira duhet të delegojnë edhe kompetencat e nevojshme për vendimmarrjen e kësaj njësie.

33. Këto kompetenca i delegohen si rregull drejtuesit të njësisë së përbashkët.

34. Delegimi i kompetencave duhet të bëhet në përputhje me parashikimet përkatëse në Kodin e Procedurave Administrative dhe në ligjin nr. 90/2012.

35. Në urdhrin për krijimin e njësisë së përbashkët duhet të përcaktohen saktësisht mjediset dhe mjetet e nevojshme materiale, të cilat do t'i shërbejnë njësisë së përbashkët për realizimin e detyrave të saj funksionale. Në rast se janë përfshirë disa institucione, në urdhër përcaktohet përgjegjësia e çdo institucioni.

36. Në urdhrin për krijimin e njësisë së përbashkët duhet të përcaktohen saktësisht mjetet buxhetore dhe financiare që duhet të mbulojnë veprimtarinë e saj. Në rast se këto mjete nuk mbulohen nga buxhetet e institucioneve të përfshira ose nuk ishin parashikuar në fondet e tyre, atëherë përpara ngritjes së njësisë kërkohet detyrimitisht mendimi nga Ministria e Financave.

37. Ministria e Financave në bashkëpunim me institucionet e përfshira ndjek procedurat e nevojshme për shpërndarjen e fondeve duke zbatuar legjislacionin përkatës për buxhetin e shtetit.

38. Në urdhrin për krijimin e njësisë së përbashkët duhet të përcaktohet nëse kjo njësi do të ketë natyrë të përhershme apo të përkohshme.

39. Në rast se ngritja e njësisë përcaktohet që të jetë me afat, në urdhër përcaktohet periudha kohore, brenda së cilës njësi duhet të realizojë detyrat administrative dhe qëllimin për të cilin është krijuar.

40. Urdhri, gjithashtu, duhet të përcaktojë dhe mënyrën e arkivimit të dokumentacionit të prodhuar

nga njësia e përbashkët me pushimin e ekzistencës së saj.

41. Të dhënat e mësipërme mund të ndryshohen në çdo kohë, sipas rastit, nga Kryeministri/ministri përgjegjës me urdhër apo ministrat e përfshirë me urdhër të përbashkët, duke përcaktuar qëllimin, objektin, afatin, personelin, infrastrukturën apo mjetet financiare të tjera, por duke zbatuar në çdo rast kërkesat e pikave 21-41, të kreut IV, të këtij vendimi.

42. Titullarët e institucioneve të përfshira në njësinë e përbashkët mblidhen çdo gjashtë muaj për t'u informuar nga drejtuesi i njësisë në lidhje me ecurinë e punës dhe realizimin e detyrave administrative që i janë ngarkuar.

43. Punonjësit e njësisë së përbashkët, çdo 6 (gjashtë) muaj, vlerësohen për ecurinë e tyre në punë në njësi. Ky vlerësim nuk ndikon në vlerësimin e tyre të përgjithshëm që bëhet sipas legjislacionit specifik që rregullon marrëdhënien e tyre të punës.

KREU V

BASHKËPUNIMI NDËRMJET INSTITUCIONEVE QENDRORE DHE VENDORE NË FUNKSION TË PROCESIT TË LEGALIZIMIT TË NDËRTIMEVE PA LEJE

(Shtuar me VKM-në nr. 435, datë 26.6.2024)

1. ASHK-ja dhe bashkitë, sipas ndarjes territoriale, bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë veprimtarinë administrative, në kuadër të trajtimit me prioritet dhe përfundimit të procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje, në zbatim të legjislacionit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë. Bashkëpunimi ndërmjet ASHK-së dhe çdo bashkie në këtë proces realizohet nëpërmjet marrëveshjes përkatëse, të nënshkruar sipas modelit të shtojcës A, që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Rregullat për bashkëpunimin, sipas këtij kreu, zbatohen vetëm për procedurat administrative të papërfunduara në zonat me prioritet zhvillimin urban, për të cilat janë miratuar nga bashkia dokumente të planifikimit të territorit, në kuptim të ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, si dhe për zonat informale, në të cilat evidentohet nga bashkia një numër i konsiderueshëm ndërtimesh pa leje, që shërbejnë kryesisht për funksione banimi.

3. Për qëllim të këtij procesi, ASHK-ja dhe bashkia shkëmbejnë informacion në mënyrë të vazhdueshme, sipas mënyrave të përcaktuara në këtë vendim, bashkërendojnë veprimtarinë administrative nëpërmjet asistencës dhe mbështetjes teknike në terren, si dhe lehtësojnë ndërveprimin e ndërsjellë.

4. ASHK-ja dhe bashkia vlerësojnë nevojën dhe mundësitë reale për realizimin e këtij bashkëpunimi, duke përfshirë burimet njerëzore dhe financiare në dispozicion, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim trajtimin me prioritet dhe përmbylljen e procesit sipas afatit të përcaktuar në marrëveshje.

5. Marrëveshja zbatohet vetëm për ndërtimet pa leje brenda territorit, që mbulon bashkia, sipas ndarjes territoriale në fuqi. Me qëllim zbatimit efektiv të këtij vendimi, bashkia harton listën e nënzonave dhe identifikon bllokun gjeografik prioritar, në funksion të planifikimit të territorit dhe i dërgon ASHK-së listën përkatëse.

6. Ministri i Shtetit për Pushtetit Vendor koordinon procesin e zbatimit të këtij vendimi, si dhe të marrëveshjes ndërmjet ASHK-së dhe bashkisë përkatëse.

7. Objekti i bashkëpunimit ndërmjet ASHK-së dhe bashkive përfshin:

a) shkëmbimin në mënyrë të ndërsjellë të informacionit, lidhur me procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim administrimin e të dhënave dhe monitorimin e ecurisë së procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje;

b) identifikimin e subjekteve dhe evidentimin në terren. Bashkia, për efekt të planifikimit dhe të zhvillimit urban, mund të identifikojë subjektet që kanë paraqitur kërkesa për legalizim sipas ligjit dhe të evidentojë në terren objektet pa leje në proces legalizimi, që ndodhen në zonën/bllokun kadastral gjeografik me prioritet zhvillimi urban dhe zonë informale banimi;

c) informimin dhe mbështetjen për plotësimin e dokumentacionit dhe evidentimin. Bashkia koordinon me ASHK-në dhe informon subjektet që kanë paraqitur kërkesa për legalizim të ndërtimeve pa leje në zonat objekt i këtij vendimi, lidhur me procedurat e legalizimit, si dhe ofron asistencën e mbështetjen për plotësimin e dokumentacionit, procesin e evidentimit në terren e në përfundim njoftimin për vendimmarrjen;

d) bashkëpunimin gjatë procesit të evidentimit në terren të ndërtimeve pa leje në zonën/bllokun kadastral, nëpërmjet angazhimit të ndërsjellë të burimeve të nevojshme njerëzore e financiare, në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar.

8. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet ASHK-së dhe bashkive, sipas parashikimeve të këtij vendimi, kryhet në rrugë shkresore dhe/ose elektronike.

9. Në funksion të realizimit të këtij procesi, bashkia përkatëse:

a) njofton subjektet që kanë aplikuar për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonën me prioritet zhvillimi urban dhe zonën informale të banimit, që të paraqesin kopje të kërkesës për legalizim apo dokumentacion tjetër të nevojshëm për trajtimin me prioritet të procesit;

b) administron të dhënat dhe e plotëson atë me informacionin për të dhënat e objekteve ndërtim pa leje dhe subjektet përkatëse, sipas zonave/blloqeve përkatëse, që do t'i nënshtrohen procesit, duke i ndarë sipas kategorive përkatëse;

c) përcjell informacionin e grumbulluar dhe të konsoliduar në funksion të evidentimit të subjekteve dhe të ndërtimeve objekte pa leje të zonës/bllokut përkatës të ASHK-ja;

ç) vepron si ndërlidhës/ndërmjetës ndërmjet ASHK-së dhe komunitetit vendor në zonën përkatëse, lidhur me procesin e matjeve në terren të objekteve të ndërtimeve pa leje, kontribuon në ndërgjegjësimin e tij, si dhe lehtëson komunikimin e ndërveprimit e ndërsjellë ndërmjet ASHK-së dhe subjekteve.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në funksion të realizimit të këtij procesi:

a) bashkëpunon me bashkinë për evidentimin e ndërtimeve pa leje në territorin e zonave me prioritet zhvillimi urban e të zonave informale të banimit dhe identifikimin e subjekteve që kanë paraqitur kërkesat;

b) merr masa administrative për caktimin e punonjësve përkatës në funksion të bashkërendimit të veprimtarive administrative me bashkinë, si dhe për realizimin e procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje, me volumin e kërkesave të evidentuara për këto zona;

c) angazhohet të trajtojë me prioritet, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kërkesat e subjekteve për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban e të zonave informale të banimit, si dhe të njoftojë subjektet për vendimmarrjen dhe bashkinë.

11. ASHK-ja trajton kërkesat e subjekteve për ndërtimet pa leje që ndodhen në këto zona, në përputhje me kriteret dhe procedurat e parashikuara në ligjin nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

12. ASHK-ja dhe bashkia rakordojnë e koordinojnë të dhënat e mbledhura, si dhe japin përkatësisht informacion periodik te ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor.

13. Në çdo rast, trajtimi me prioritet i kërkesave të subjekteve për legalizimin e ndërtimeve pa leje, të propozuara nga bashkia, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi, nuk pengon vijimin e veprimtarisë administrative të ASHK-së për legalizimet e ndërtimeve pa leje në zonat që ndodhen jashtë këtyre zonave/blloqeve kadastrale, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 20/2020, "Për

përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

14. ASHK-ja u propozon bashkive lidhjen e marrëveshjeve brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Shtojca A
(Shtuar me VKM-në nr. 435, datë 26.6.2024)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

(SHTOJCA A)

BASHKIA.....

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

Nr. ____ prot. Datë __. __. 2024

Nr. ____ prot. Datë __. __. 2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI (TIP)

“Agjencia Shtetërore e Kadastrës” (ASHK), me seli në Tiranë, rruga “Dora d’Istria”, person juridik publik, përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm, znj. Dallëndyshe Bici;
dhe

“Bashkia _____”, me seli në, person juridik publik, përfaqësuar nga kryetari

të dyja së bashku të referuara më poshtë si “Palët”;

të ndërgjegjshëm për rëndësinë e trajtimit me prioritet të procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje, në përputhje me legjislacionin në fuqi për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë, si dhe të rritjes së efikasitetit të këtyre procedurave administrative;

të ndërgjegjshëm se përfshirja e bashkive në procese që lidhen me administrimin e territorit mundëson zbatimin më efikas të legjislacionit për planifikimin e territorit dhe është më pranë qytetarit;

palët bien dakord për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje sipas kushteve dhe afateve si vijon:

Neni 1 Qëllimi

Kjo marrëveshje parashikon mënyrën e bashkëpunimit, ndërveprimit dhe koordinimit ndërmjet palëve, në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fuqi për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë dhe të trajtimit me prioritet të procedurave administrative të papërfunduara, për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonat informale të banimit.

Neni 2 **Baza ligjore**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi bazohet në kuadrin ligjor në fuqi dhe konkretisht në:

- Kushtetutën e Shqipërisë;
- Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr. 111/2018, “Për kadastrën”;
- Ligjin nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;
- Ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Neni 3 **Objekti**

Objekti i kësaj marrëveshjeje është përcaktimi i rregullave të bashkëpunimit, ndërveprimit dhe koordinimit midis ASHK-së dhe bashkisë, në kuadër të proceseve të papërfunduara për legalizimin e ndërtimeve pa leje, brenda territorit të Bashkisë, në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonat informale të banimit.

Neni 4 **Parimet e bashkëpunimit**

Zbatimi i bashkëpunimit, sipas parashikimeve të kësaj marrëveshjeje, realizohet në respektim të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe autonomisë vendore, të ligjshmërisë, transparencës, efikasitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Neni 5 **Mënyra e bashkëpunimit**

Në kuadër dhe në zbatim të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, palët angazhohen të bashkëpunojnë, bashkëveprojnë dhe koordinohen, në lidhje me sa vijon:

- të shkëmbejnë në mënyrë reciproke informacion, lidhur me ecurinë e procesit të legalizimit në funksion të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në përputhje me legjislacionin e posaçëm për proceset tranzitore;
- të komunikojnë, bashkërendojnë dhe koordinojnë veprimtarinë administrative ndërmjet tyre, në funksion të realizimit të kësaj marrëveshjeje;
- të organizojnë e marrin pjesë në takime të përbashkëta, përcaktojnë planin e punës, si dhe grafikonin e prioriteteve në funksion të trajtimit me prioritet të procesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- të caktojnë burime njerëzore të nevojshme për administrimin efikas të procesit administrativ. Për këtë qëllim, ASHK-ja dhe bashkia vlerësojnë nevojën dhe mundësitë reale për realizimin të këtij bashkëpunimi, duke përdorur të gjithë mekanizmat ligjore, financiare dhe/ose në burime njerëzore në dispozicion për përmbylljen e procesit sipas afatit të përcaktuar në këtë marrëveshje. Bashkia, sipas

rastit, mund të transferojë fond me terma dhe specifikime të veçanta, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, në favor të ASHK-së, për të mbuluar shpenzimet e pagave të stafit që do të angazhohet për zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Në çdo rast, nëse palët vendosin transferimin e fondit nga bashkia tek ASHK-ja, fondi përdoret nga ASHK-ja vetëm për qëllim të realizimit të kësaj marrëveshjeje dhe në përputhje me specifikimet përkatëse. Bashkia, sipas rastit mund të vendosë në dispozicion të ASHK-së, nëpërmjet transferimit të punonjësve të bashkisë pranë ASHK-së, në funksion të realizimit të qëllimeve të kësaj marrëveshjeje. Në këtë rast, për periudhën e kohëzgjatjes së marrëveshjes, stafi i nënshtrohet procedurave ligjore të punësimit, sipas Kodit të Punës dhe legjislacionit në fuqi për kadastrën;

- të informojnë ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, në mënyrë periodike, në lidhje me ecurinë e zbatimit të marrëveshjes dhe të VKM-së për “Rregullimin e bashkëpunimit midis institucioneve qendrore dhe vendore, për përshpejtimin e procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje”;

- të bashkëpunojnë për realizimin sa më efikas, transparent dhe profesional të procesit administrativ në çdo formë tjetër që vlerësohet e nevojshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6

Angazhimet e palëve

(Shtuar shkronja “gj” e pikës 2 me vendimin nr. 727, datë 20.11.2024)

1. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në zbatim të kësaj marrëveshjeje, angazhohet të kryejë si vijon:

a) të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për identifikimin dhe evidentimin e kërkesave të subjekteve për legalizimin e ndërtimeve pa leje në territorin e zonave me prioritet zhvillimi urban dhe zonave informale të banimit;

b) të organizojë dhe të caktojë stafin e drejtorisë vendore të ASHK-së, në territorin e së cilës ndodhen nënzonat e propozuar nga bashkia, në funksion të realizimit të këtij procesi me volumin e kërkesave;

c) të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për shpenzimin e fondit të transferuar nga bashkia sipas përcaktimeve të kësaj marrëveshjeje. Të ndërmarrë të gjitha veprimet dhe procedurat e nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, në lidhje me punësimin e stafit të bashkisë për periudhën e kohëzgjatjes së marrëveshjes;

ç) të bashkëpunoj me stafin e bashkisë në kryerjen e procedurave të evidentimit në terren të objekteve në proces legalizimi në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonave informale të banimit;

d) të kryejë veprimet e evidentimit në terren për objektet pa leje në zonat/bllokun gjeografik prioritar të propozuar nga bashkia, në prezencë të përfaqësuesve të caktuar të palëve. Përfaqësuesit e palëve nënshkruajnë procesverbalin (formular informativ) të miratuar nga drejtori i përgjithshëm i ASHK-së me urdhër të brendshëm;

e) të trajtojë me prioritet, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kërkesat e subjekteve për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonave informale të banimit;

f) të informojë bashkinë, pa vonesë, nëpërmjet përfaqësuesit të caktuar si person kontakti, për problematikat e hasura gjatë procedurës administrative, duke propozuar zgjidhje në funksion të ecurisë së procesit.

2. Bashkia, në zbatim të kësaj marrëveshjeje, angazhohet të kryejë si vijon:

a) të identifikojë dhe hartojë një listë të subjekteve për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonave informale, kryesisht me funksion banimi, të ndara sipas nënzonave. Për këtë qëllim, bashkia harton listën me nënzonat brenda territorit dhe ia dërgon atë ASHK-së;

b) të përcjell te ASHK-ja nëpërmjet përfaqësuesit të caktuar si person kontakti, informacionin e grumbulluar dhe konsoliduar mbi evidentimin e subjekteve dhe ndërtimeve pa leje të zonës/bllokut përkatës, për procesim të mëtejshëm sipas legjislacionit në fuqi;

c) të vlerësojë krijimin e njësisë përgjegjëse dhe të caktojë stafin që do të përfshihet në administrimin e procesit sipas parashikimeve të kësaj marrëveshjeje;

ç) të identifikoj stafin e specializuar që do të vihet në dispozicion të ushtrisë detyrat pranë ASHK-së gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi, për propozimin dhe vënien në dispozicion për efekt të realizimit të parashikimeve të kësaj marrëveshjeje. Të identifikojë fondin që mund t'i transferohet nga ASHK-ja, për qëllim të realizimit të kësaj marrëveshjeje dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi për transferimin e fondit sipas parashikimeve të kësaj marrëveshjeje;

d) të ofrojë ndihmë dhe informacion nëpërmjet stafit të bashkisë për subjektet mbi statusin e aplikimit dhe fazën apo ecurinë e procesit, në bllokun gjeografik prioritar të identifikuar nga bashkia;

e) të informojnë dhe sensibilizojnë subjektet në nënzona për procedurat e evidentimit në terren të ndërtimeve pa leje që do të kryhet nga ASHK-ja, si dhe të asistojë stafin e ASHK-së gjatë kryerjes së procedurave të evidentimit në terren të ndërtimeve pa leje;

f) të marrë pjesë në veprimet e evidentimit në terren për objektet pa leje në zonat/bllokun gjeografik prioritar të propozuar nga bashkia, në prezencë të përfaqësuesve të caktuar të palëve. Përfaqësuesit e palëve nënshkruajnë procesverbalin (formular informativ) të miratuar nga drejtori i përgjithshëm i ASHK-së me urdhër të brendshëm;

g) të informojë ASHK-në, në lidhje me projektet/studimet e bashkisë, të miratuara në zbatim të legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

gj) në rastet kur evidentimi në terren kryhet nga specialistët e bashkisë, akti i evidentimit në terren nënshkruhet prej tyre, sipas formatit të miratuar në vendimin nr. 1178, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje", të ndryshuar.

Neni 7

Komunikimi midis palëve

Rakordimi i veprimeve administrative dhe shkëmbimi i informacionit shkëmbimit të informacionit kryhet vetëm në formë shkresore dhe/ose elektronike.

Neni 8

Përdorimi i informacionit

Informacioni i mbledhur, përpiluar, procesuar dhe shkëmbyer midis palëve, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, përdoret vetëm për realizimin e bashkëpunimit sipas parashikimeve të kësaj marrëveshjeje.

Neni 9

Shkëmbimi i informacionit në mënyrë periodike

1. Përfaqësuesit e palëve mbajnë kontakt të vazhdueshëm, në funksion të zbatimit efektiv të kësaj marrëveshjeje. Përfaqësuesit zhvillojnë çdo muaj takime, në lidhje me ecurinë e procesit administrativ.

2. Në fund të çdo muaji, çdo përfaqësues harton informacion të detajuar mbi ecurinë e procesit dhe ia dërgon përkatësisht drejtorit të ASHK-së dhe kryetarit të bashkisë. Drejtori i ASHK-së dhe

kryetari i bashkisë i dërgojnë, çdo muaj, ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor informacionin e detajuar mbi ecurinë.

Neni 10

Afati i marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët dhe është e vlefshme 1 (një) vit nga momenti i nënshkrimit të saj.

2. Çdo ndryshim i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi bëhet në formë shkresore dhe me miratimin e të dyja palëve.

3. Secila palë, nëse për arsye objektive është në pamundësi objektive për të përmbushur angazhimet sipas kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, mund ta zgjidhë atë në mënyrë të njëanshme në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim palën tjetër të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara.

4. Secila palë mund ta zgjidhë marrëveshjen në çdo kohë, nëse pala nuk respekton detyrimet e përcaktuara dhe nuk merr masa për rregullimin e pasojave, brenda 10 ditëve nga njoftimi me shkrim i palës tjetër.

Kjo marrëveshje hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje origjinale.

BASHKIA

AGJENCIA SHETETËRORE E KADASTRËS

KRYETAR

DREJTOR I PËRGJITHSHËM